



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 28, datë 03.12.2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “STRUKTURË HOTELERIE**  
**4, 5, 7 DHE 9 KATE, ME 2 KATE PARKIMI NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË**  
**BASHKINË DURRËS**


Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Rinia 04” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë hotelerie 4, 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Durrës, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

**BLENDI KLOSI**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MARRËVESHJE  
PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë 03.12.2020, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Durrës**, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Znj. Emiriana Sako

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.28, datë 03.12.2020, për objektin: “Strukturë hotelerie 4, 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**  
**OBJEKTI**

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Durrës për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Strukturë hotelerie 4, 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.28, datë 03.12.2020.





## **NENI 2 KOHËZGJATJA**

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Durrës, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

## **NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Durrës të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.28, datë 03.12.2020, për objektin: “Strukturë hotelerie 4, 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k
- dhe
- ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që shoqërojnë këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Durrës ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Strukturë hotelerie 4, 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k
  - ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në këtë zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.



- iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: “Strukturë hotelerie 4, 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me zhvillues shoqërinë “Rinia 04” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.28, datë 03.12.2020:
- Leje Ndërtimi;
  - Leje Ndërtimi për prishje të objekteve ekzistuese;
  - Çertifikatë Përdorimi.

#### **NENI 4 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 4.1 Palët do t’i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

#### **NENI 5 GJUHA E MARRËVESHJES**

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

#### **NENI 6 EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI**

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

#### **PALËT**

##### **KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

Përfaqësuar nga,

**Z. EDI RAMA**

##### **BASHKIA DURRËS**

Përfaqësuar nga,

**ZNJ. EMIRIANA SAKO**